

VENDIM
Nr. 723, datë 28.8.2013

**PËR LEJIMIN E KOMUNËS GREKAN TË QARKUT TË ELBASANIT, SI AUTORITET
KONTRAKTOR, TË VIJOJË KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT ME
OBJEKT “SISTEMIMI I KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA PËR FSHATIN
DËSHIRAN, KOMUNA GREKAN, ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e komunës Grekan të qarkut të Elbasanit, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit me objekt “Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan, Elbasan”.

2. Ngarkohen komuna Grekan e qarkut të Elbasanit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha